



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

**VENDIM**

**Nr. 340, datë 04.08.2021**

**“PËR MOSPRANIMIN E KËRKESËS PËR DALJEN NË PENSION TË PARAKOHSHËM TË GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT DURRËS, Z. {...}”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 04.08.2021, pasi u njoh me Kërkesën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...} (protokolluar me aktin nr. 3436, datë 19.07.2021) dhe me materialet e çështjes të përgatitura nga relatorja Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VËREN:**

**I. FAKTET E ÇËSHTJES**

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 19.07.2021, është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...}, me nr. 3436 prot., me objekt kërkim për përfitim të pensionit të parakohshëm, referuar nenit 27 pika 1/a, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Si shkak të paraqitjes së kërkesës, magjistrati ka parashtruar moshën e tij, mbi 60 vjeç.

2. Në nenin 27 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se :

*1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:*

*a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;*

*b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit;*

*1/1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm edhe në rast se Këshilli vendos mbarimin e statusit të magjistratit për shkak pamundësie fizike dhe mendore sipas nenit 67 të këtij ligji.*

*1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më qe del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni është 0.6 % në muaj.*

*2. Magjistrati që ushtron funksionin në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe Prokurorinë e Posaçme, gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm tre muaj më parë, për çdo vit të ushtrimit të funksionit në këto struktura.*

*3. Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë.*

*4. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, në të cilat përcaktohet:*

*a) procedura që ndiqet për kërkesat për pension të parakohshëm dhe dokumentacionin mbështetës;*

*b) rregullat për mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm dhe përfitimeve të tjera, në rastet kur kërkesa pranohet”.*

*3. Sipas të dhënave të dosjes personale të gjyqtarit, administruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...} është i datëlindjes 11.01.1961, çka do të thotë se ai, në momentin e paraqitjes së kërkesës, ka qenë mbi 60 vjeç.*

*4. Në kuadër të trajtimit të kërkesës së z. {...}, sa i përket periudhës së ushtrimit të funksionit të magjistratit, u administrua Informacioni datë 22.07.2021, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ngarkuar për përpunimin e të dhënave të dosjeve personale të gjyqtarëve. Sipas këtij informacioni rezulton se :*

*“Zoti {...} ka përfunduar studimet në fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës (kurs i plotë i përsheptuar) më datë 8.07.1994, diplomuar Jurist. Me Vendimin nr. 13 datë 24.11.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet ndihmës gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gramsh .*

*Me Vendimin nr. 5 datë 1.07.1994 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është transferuar ndihmës gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Elbasan.*

*Me Vendimin nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar dhe njëkohësisht zëvendës kryetar në Gjykatën e Rrethit Elbasan.*

*Me Vendimin nr. 229/A, datë 21.04.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

*Me Vendimin nr. 297/3 datë 15.11.2012 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, riemërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Elbasan.*

*Me Dekretin nr. 9534, datë 25.04.2016 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.*

*Me Vendim nr. 214, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është shkarkuar nga detyra".*

6. Në momentin e paraqitjes së kërkesës nga z. {...}, periudha e ushtrimit nga ai të funksionit të magjistratit (gjyqtarit), përfshirë këtu edhe periudhën e ushtrimit të detyrës së ndihmësgjyqtarit, rezulton të jetë 26 vjet.

7. Bazuar në pikën 3 të nenit 27 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se: “*Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë*”, nuk u kërkua nga kryetari i Gjykatës së Apelit Durrës, dhënia e mendimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit {...} për dalje në pension të parakohshëm, duke konsideruar faktin që aktualisht gjyqtari është i pezulluar nga detyra, pasi sipas vendimit nr. 214 datë 22.11.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur shkarkimi i tij nga detyra.

## **II. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJIROKASTRË**

8. Në vlerësim të rrethanave të faktit dhe ligjit të zbatueshëm, Këshilli i Lartë Gjirokastrë arrin në përfundimin se gjyqtari {...} nuk plotëson kushtet për njohjen e të drejtës së pensionit të parakohshëm sipas pikës 1, të nenit 27, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji për Statusin). Ndaj kërkesa e z. {...} nuk mund të miratohet nga Këshilli, duke qenë rasti për të vendosur mospranimin e saj.

9. Për arritjen në përfundimin e pabazueshmërisë së kërkesës së gjyqtarit {...}, Këshilli i Lartë Gjirokastrë mbajti në konsideratë se Ligji për Statusin, në Kreun III, rregullon pagën dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore të magjistratit. Përfitimet e tjera financiare të magjistratit listohen në nenin 11, pika 3, të këtij kreu të ligjit, e konkretisht:

- *“kompensim për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm” (shkronja “a”),* përfitim ky që rregullohet më tej në nenin 15, të këtij kreu të ligjit;

- *“shpërblim për aftësi” (shkronja “b”),* përfitim ky që rregullohet më tej në nenin 16, të këtij kreu të ligjit;

- *“pension shtetëror suplementar, sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjislacionit për pensionet shtetërore suplementare”* (shkronja “c”), përfitim ky që rregullohet më tej në nenin 21, të këtij kreu të ligjit;

- *“çdo përfitim tjetër, duke u bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen personale dhe atë familjare të magjistratit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”* (shkronja “ç”), përfitim ky që rregullohet më tej në nenet 17 dhe 19, të këtij kreu të ligjit.

10. Nga ana tjetër, në Kreun V, të Ligjit për Statusin, rregullohen *“Të drejta të tjera”* të magjistratit, ku në nenin 27 të këtij kreu, rregullohet e drejta e *“Pensionit të parakohshëm”*.

11. Në rastin në shqyrtim është shtruar e drejta e magjistratit për *“pension të parakohshëm”*, e drejtë për të cilën, në vlerësim të Këshillit, Ligji për Statusin kërkon plotësimin njëkohësisht nga magjistrati të dy kushteve e konkretisht: 1) *moshën minimale prej jo më pak se 60 vjeç*; dhe 2) *periudhën minimale të shërbimit në detyrë (ushtrimit të funksionit të magjistratit) prej jo më pak se 30 vjet*.

12. Në rastin e z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se nuk vërtetohet plotësimi i kushtit të dytë, pra ai i periudhës minimale të shërbimit në detyrë (ushtrimit të funksionit të magjistratit) prej jo më pak se 30 vjet, ndërsa rezulton që kjo periudhë të jetë 26 vite. Edhe nëse në këtë llogaritje do të përfshinin periudhën gjatë së cilës gjyqtari është pezulluar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pra periudhën gjatë së cilës gjyqtari nuk ushtron funksionin e tij por gëzon akoma statusin e magjistratit, edhe në këtë situatë nuk rezulton që gjyqtari të plotësojë 30 vjet në ushtrimin e profesionit si magjistrat.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndryshe nga sa z. {...} ka pretenduar në kërkesën e tij, vlerëson se kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 27, të Ligjit për Statusin janë kumulative, pra kushte që duhet të ekzistojnë njëkohësisht të gjitha dhe jo alternative.

14. Për arritjen në këtë përfundim mbi përmbajtjen dhe kuptimin e dispozitës në fjalë, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në interpretimit gjuhësor, literal ose gramatikor të saj, pra në bazë të analizës së testit të dispozitës sipas kuptimit të fjalëve, rregullave gramatikore dhe të sintaksës.

14.1 Nga interpretimi gjuhësor të rregullit sipas pikës 1, të nenit 27, të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se mënyra e formulimit të fjalisë kryesore së dispozitës (*Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:*) dhe pikërisht lidhëza nënrenditëse *“nëse”* dhe shënja e pikësimit “:”, paralajmërojnë shtjellime numëruese sqaruese duke rreshtuar një pas një kushtet e kësaj të drejte përmes fjalive kushtore të varura (a) *nëse ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç*; (b) *nëse ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit*), fjali këto të fundit që janë bashkuar pa lidhëza, por që ndahen nëpërmjet shenjës së pikësimit “;”, duke shërbyer për të zberthyer përmbajtjen e fjalisë kryesore. Nga ana

tjetër, dy fjalitë e varura, ndërsa nuk lidhen me anë të lidhëzave bashkërenditëse veçuese, të tilla si: ose, apo etj, nuk mund të interpretohet se përmbajnë dy kushte alternative të të drejtës së pensionit të parakohshëm, që bën fjalë fjalia kryesore e dispozitës.

14.2 Po ashtu, nga interpretimi gjuhësor i rregullit sipas pikës 1/2, të nenit 27, të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në fjalinë e fundit të kësaj pike të dispozitës, përmes të cilës përcaktohet koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, indirekt përcaktohen dhe subjektet mbajtës të së drejtës, pikërisht *“magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni”*. Pra ligji shprehimisht përcakton si mbajtës të së drejtës së pensionit të parakohshëm ata magjistratë që plotësojnë *“kushtet”*, ku kudrinori në këtë rast është një emër në numrin shumës (kushtet), domethënë të dy kushtet e parashikuara në pikën 1, të kësaj dispozite.

15. Përveç sa më lart, për arritjen në përfundimin se kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 27, të Ligjit për Statusin, janë kushte kumulative, Këshilli i Lartë Gjyqësor bazohet edhe në metodat e tjera të interpretimit ligjor, si atë sistematik, logjik, historik dhe teologjik.

15.1 Kështu, Këshilli i Lartë Gjyqësor mban në konsideratë se në pikën 1/2 të shtuar në nenin 27 të Ligjit për Statusin përcaktohet shprehimisht se: *“Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar ...”*. Nëpërmjet këtij përcaktimi ligjvënësi ka definuar me tej atë çka përfaqëson *“pensioni i parakohshëm”* i magjistratit.

15.2 Në fakt, legjislacioni shqiptar kuadër që rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore (Ligji nr. 7703/1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij), si pjesë të skemës së sigurimit shoqëror të detyrueshëm ka parashikuar edhe *“pensionin e pleqërisë”* (të plotë ose të reduktuar). Parimisht, rregullimet sipas këtij ligji janë të zbatueshme edhe për magjistratët, si për çdo qytetar tjetër të Republikës së Shqipërisë. Por, pavarësisht kësaj, ligjvënësi, nëpërmjet rregullimeve të posaçme në Ligjin për Statusin dhe pikërisht përmes nenit 27 të tij, duke mos patur për qëllim thjesht rikonfirmim e të drejtës së *“pensionit të parakohshëm”* për magjistratët, në realitet ka synuar përcaktimin e kushteve të veçanta të kësaj të drejte për ata, pikërisht të kushteve më të favorshme, duke u nisur nga dinjiteti, rëndësia dhe karakteri i veçantë i detyrës dhe shërbimit të magjistratëve.

15.3 Legjislacioni shqiptar kuadër që rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore, sa i përket *“pensionit të pleqërisë”* (të plotë ose të reduktuar), përcakton dy kushte përfitimi dhe konkretisht: 1) moshën dhe 2) *periudhën/vitet e sigurimit (periudha për të cilën për të punësuarin janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore)*.

15.4 Ligji i veçantë, Ligji për Statusin, tashmë parashikon dy kushte përfitimi *“pensioni të parakohshëm”* për magjistratët, sikundër edhe për çdo qytetar tjetër të Republikës së Shqipërisë, por më të favorshme, duke përcaktuar një moshë më të ulët dhe një periudhë sigurimi më të

shkurtër, me veçantinë që vitet e sigurimit kërkohen eskuzivisht për periudhën e shërbimit/ushtrimit të funksionit të magjistratit, që nga sa duket ka qenë element i rëndësishëm për ligjvënësin lidhur me të drejtën e *“pensionit të parakohshëm”* për magjistratët.

15.5 Nga ana tjetër, sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore, pjesë e të cilit është dhe sistemi i pensioneve, ku përfshihet edhe *“pensioni i parakohshëm i magjistratëve”* që klasifikohet si *“pension pleqërie i reduktuar”*, pjesë e skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror, është një sistem kontributiv, që nënkupton derdhjen nga përfituesit të një kontributi financiar në skemën përkatëse të financimit apo që ata të kenë një numër minimal periudhash veprimtarie profesionale para se të mund të marrin përfitime.

15.6 Nga sa më lart, ndërsa kuadri i përgjithshëm ligjor në Republikën e Shqipërisë për sistemin e sigurimeve shoqërore, si kusht përfitimi pensioni pleqërie (të plotë ose të reduktuar), krahas moshës, kërkon edhe një periudhë minimale sigurimi apo veprimtarie profesionale, është e pamundur të arrihet në përfundimin se për magjistratët nuk kërkohet një gjë e tillë apo se Ligji për Statusin ka synuar të dalë tej kuadrit të përgjithshëm ligjor në fushën e sigurimeve shoqërore.

15.7 Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se nëse do të pranohej e kundërta nga sa më lart, pra që kushtet e përfitimit nga magjistratët të *“pensionit të parakohshëm”* sipas nenit 27, pika 1, të Ligjit të Statusit janë kushte alternative, atëherë kjo do të çonte në mohim të ligjit, pikërisht të përcaktimit të shprehur ligjor se *“pensioni i parakohshëm i magjistratëve”* është *“pension pleqërie i reduktuar”*, pra si një e drejtë nga sigurimet shoqërore të detyrueshme, përveç se edhe në mohim të kornizës së përgjithshme ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore.

#### **IV. KONKLUZIONE**

16. Bazuar në situatën faktike dhe legjislacionin në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se magjistrati, gjyqtari {...}, nuk përmbush kushtet e kërkuara nga ligji, pikërisht atë të përcaktuar në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 27, të Ligjit për Statusin, për njohjen e të drejtës së *“pensionit të parakohshëm”*. Nisur nga kjo, ndërsa sipas pikës 3, të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, është ai organi përgjegjës që ka kompetencën e miratimit të pensionit të parakohshëm të gjyqtarit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se është vendi për të vendosur mospranimin e kërkesës për daljen në pension të parakohshëm të gjyqtarit {...}.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 1 gërma b, të nenit 27 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për daljen në pension të parakohshëm të magjistratit, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

**VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për dalje në pension të parakohshëm të gjyqtarit {...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} dhe Gjykatës së Apelit Durrës.
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**